



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 13-016/01-0040917/23
Dt.15.06.2023

Bazuar në Nenet 79 dhe 80 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Rregulloren (Qrk) Nr. 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, si dhe në bazë të kërkesës së QKMF-së Nr.1119, Njësia e Burimeve Njerëzore shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Pozita: Mirëmbajtës - 1 (një) pozitë

Koeficienti: GJ50 - 3.8

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Kryen punë të ndryshme zejtare të nevojshme lidhur me meremetime të vogla të rrymës, ujit në të gjitha njësitë-repartet e QKMF, QMF dhe AMF në terren;
- Bënë mirëmbajtjen e të gjitha instalimeve të rrymës, ujit, kanalizimit dhe nxemjes;
- Mirëmbajtja e ndërtesave në Qendër dhe terren (mbledhja e mbeturinave në QKMF, QMF-të dhe AMF-të, kositja e barit në oborret e tyre në rast nevojë roje, punë në laurë etj.);
- Mirëmban parkingun, kopshtin etj;
- Sipas urdhërësës së eprorit kryen edhe punë të tjera nga lëmia e tij;
- Për punën e vet i përgjigjet përgjegjësit të punëve teknike, Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuar:

-Diplomë e Shkollës së Mesme

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Dokumentet e Kërkuara:

- Diploma e kualifikimit përkatës;
- Kopja e Letërnjoftimit;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor që dëshmon se gjendja e kandidatit është pa probleme shëndetësore (Kjo dëshmi sillet pas pranimi në mardhënje pune të kandidatit);
- Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.

Afati i aplikimit:

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 15.06.2023 deri me dt.29.06.2023.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë, nga data 30.06.2023 deri me datën 14.07.2023.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit dhe një interviste me gojë. Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Njësinë e Burimeve Njerëzore, në këtë numër të telefonit 038 200 41-014.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>